



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MEMALIAJ

Datë 12.01.2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me karburant Gazoil (10 ppm ULSD) për nevojat e Bashkisë Memaliaj dhe Njësitë Administrative të saj viti 2023**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
09100000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: \_\_ 4.580.000 (kater milion e peseqind e tetedhete mije) Lek pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Memaliaj** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

*Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 3. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 91600 nentdhete e nje mije e gjashteqind lek pa tvsh .*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1. Sipas Shtojcës 7, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019-2020-2021**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet **për vitin 2022** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ,të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40 pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit të limitit që prokurohet që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë apo mundësinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se nuk sjell kufizim të konkurrencës. Kjo vlerë është brenda limiteve të përcaktuara në LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë*

**2.3.2** Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1(një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Memaliaj, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas kodit civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës).

**2.3.2** Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in liçensat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëng-shëm të naftës, **për automjetet**, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse **për përdorim nga konsumatorët fundorë**.

**2.3.3** Operatori/et Ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje ) pike stacioni të shitjes së karburantit (benzine ) me pakicë brenda territorit administrativ të Bashkisë Memaliaj.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport analizimi për tregun e brendshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) brenda 3(tre) muajve nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**2.3.4** Subjekti ofertues duhet të paraqesë **dhe deklaratat si më poshtë:**

a. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

b. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

**Argumentim:** Në bazë të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi me pakicë të lëndëve djegëse Karburante ose Licencë për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm naftës për automjete, vajrave lubrifikant.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim:* Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EWC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diesel”.

**Specifikimet teknike të Gazoil 10 ppm ULSD sipas standartit SSH EN 590:2013+A1: 2017**

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min	Max	
1	Numri i Cetanit		51	-	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	-	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m <sup>3</sup>	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	-	8	SSH EN ISO 12916
5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	-	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	-	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni (ne 10% mbetje destilimi)	% (m/m)	-	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	-	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	-	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	-	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 <sup>0</sup> C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	-	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	-	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40 <sup>0</sup> C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104

17	Destilimi % vol e destilati qe vlon deri ne 250°C % vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	% (v/v) % (V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924
----	---	--------------------------	----	------------	------------------------------------

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **Furnizim me karburant Gazoil (10 ppm ULSD) për nevojat e Bashkisë Memaliaj dhe Njësitë Administrative të saj viti 2023** Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**

Xhuvana Kuçi

Violeta Kanushi

Marsel Oruci

**MIRATOI  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
Gjolek GUCI**